



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.10.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të datave 24.08.2020; 26.08.2020; 04.09.2020; 08.09.2020; 08.09.2020 (ora 17:00); 09.09.2020; 10.09.2020; 11.09.2020; 11.09.2020 (ora 18:30); 14.09.2020, 16.09.2020; 17.09.2020 dhe 18.09.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 24.08.2020; 26.08.2020; 04.09.2020; 08.09.2020; 08.09.2020 (ora 17:00); 09.09.2020; 10.09.2020; 11.09.2020; 11.09.2020 (ora 18:30); 14.09.2020, 16.09.2020; 17.09.2020 dhe 18.09.2020.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje të gjithëve.

Prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit.

Po fillojmë mbledhje e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 19 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, sot janë parashtruar 9 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e KLGJ-së, konkretisht: Miratimi i procesverbaleve të datave 24 gusht, 26 gusht, 4 shtator, 8 shtator, 8 shtator (ora 17:00), 9 shtator, 10 shtator, 11 shtator, 11 shtator (ora 18:30), 14 shtator, 16 shtator, 17 shtator dhe 18 shtator.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}” (shtyrë nga mbledhja e datës 14.10.2020).

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim të pjesshëm të vendimit nr.427, datë 13.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e katërt ka të bëjë me “Për shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor””.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. {...} (shtyrë nga mbledhja e datës 28.09.2020).

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për kualifikimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021: për kandidatin z. {...}; për kandidatin z. {...}; për kandidaten znj. {...}; për kandidaten znj. {...}; për kandidaten znj. {...}; për kandidaten znj. {...}; për kandidaten znj. {...}; për kandidaten znj. {...};

Çështja e shtatë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e tetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e nëntë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr. 181, nr. 183 dhe nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Jeni dakord me rendin e ditës?

**Fatmira Luli:** Mund të flas zonja Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po, zonja Luli!

**Fatmira Luli:** Atëherë, dua të parashtoj përpara shqyrtimit të pikës 5 Këshillit, kërkesën time për të mos marrë pjesë në votimin për z. {...}, për arsye sepse e gjykoj që është më mirë në interes të imazhit të këtij Këshilli dhe imazhit të anëtarëve të saj, në interes të publikut, që unë për shkak të faktit që burri im është subjekt i rivlerësimit dhe është në proces përfundimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nga KPK-ja, të heq dorë dhe të mos marrë pjesë në diskutimet dhe në votimin e çështjes për kandidimin e

zotit {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë, jo se në thelb ka konflikt interesi. Me këtë rast nuk dua të deklaroj se ekziston konflikti i interesit në rastin konkret, nuk ka asnjë konflikt interesi, për shkak se bashkëshorti im nuk ka një vendim përfundimtar për të cilën të ushtronte ose jo të drejtën e ankimit z. {...} si komisioner publik, por për faktin që nëse kjo vendimmarrje këtu do konceptohet nga publiku si një shpërblim nderesh që ne i bëjmë komisionerëve ose anëtarëve të KPK-së në raport me karrierën e tyre për shkak të vendimeve që ata japin në favor të të afërmeve tanë, për këtë arsye unë e gjykoj që është më mirë që të heq dorë dhe të mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e kësaj pike.

Gjithashtu dua të bëj të ditur faktin që media publikojnë fakte dhe rrethana të pavërteta edhe lidhur me çfarë ndodh në Këshill, rrethana këto për të cilat unë nuk shqetësohem fare dhe as ky Këshill, përveçse duhen bërë publike, që nuk do të jenë pjesë, nuk ushtrojnë pengesa dhe trysni ndaj tërë anëtarëve të Këshillit për të marrë vendimmarrjen që ata duan të përfitojnë nga ky Këshill.

Këtë nuk e bëj për t'i treguar asaj medias ose gazete që ka bërë publike ato fakte se unë trembem nga mesazhi që ato përcjellin, por qëllimi i kësaj dorëheqjeje dhe mosmarrje pjesë është që publiku të perceptojë që Këshilli vendos në interes dhe në bazë të ligjit dhe jo për të shkëmbyer favore dhe interesa në favor të anëtarëve të ndryshëm nga të cilët varet mirëqenia e familjes ose të afërmeve të mi.

Për këtë arsye deklaroj që nuk do marrë pjesë në votimin e çështjes dhe në diskutimin e çështjes së pikës 5.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Luli!

Pa humbur kohë, vijojmë me pjesën e rendit të ditës.

Atëherë, siç jeni në dijeni, nga stafi ju janë shpërndarë procesverbalet. Nëse keni ndonjë gjë lidhur me përmbajtjen e tyre? Nëse jo, kalojmë në miratimin e tyre?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro, me përjashtim të procesverbaleve të datave 04.09 dhe 08.09., mbledhje në të cilat unë nuk kam marrë pjesë për shkak se kam qenë i angazhuar në proceset e hedhjes së shorteve për tërheqjen e dosjeve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Pro, me përjashtim të procesverbalit të datës 04.09.2020, pasi nuk kam qenë e pranishme në mbledhje plenare, për të njëjtin shkak të relatuar edhe nga zoti Muharremaj.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 24.08.2020; 26.08.2020; 04.09.2020; 08.09.2020; 08.09.2020 (ora 17:00); 09.09.2020; 10.09.2020; 11.09.2020; 11.09.2020 (ora 18:30); 14.09.2020, 16.09.2020; 17.09.2020 dhe 18.09.2020.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.10.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magistratit, për z. {...}” (shtyrë nga mbledhja e datës 14.10.2020).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:32.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}” (shtyrë nga mbledhja e datës 14.10.2020).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e dytë i cili ka të bëjë me përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}”. Në këtë rast, projektvendimi është shpërndarë, edhe relacioni shpjegues. Më lejoni t’ju shpjegoj shkurtimisht projektvendimin.

Z.{...} ushtronte detyrën e gjyqtarit, njëkohësisht edhe të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në kohën kur hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe për rrjedhojë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai iu nënshtroi rivlerësimit “ex officio”.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe zhvillimit të bisedimeve, më datë 09.01.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, mori vendimin për përfundimin e procesit të rivlerësimit dhe u tërhoq për të dhënë vendimin përfundimtar. Më datë 10.01.2019, ende pa u shprehur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendim, subjekti i rivlerësimit z. {...} dorëzoi para këtij Institucioni një shkresë, përmes të cilës,

parashtronte dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit. E njëjta shkresë, po të njëjtën ditë, u depozitua edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më vonë, në të njëjtën ditë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpalli vendimin për subjektin e rivlerësimit, z. {...}, duke vendosur në përfundim: Shkarkimin nga detyra të tij.

Në Vendimin e tij, nr. 97, datë 10.01.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në lidhje me kërkesën për dorëheqje nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, ka arsyetuar se kërkesa është paraqitur pas marrjes së vendimit për përfundimin e procesit të rivlerësimit, vendim ky i marrë më datë 09.01.2020.

Ndërkohë, më datë 20.03.2019, z. {...} paraqiti ankim kundër Vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim mbi të cilin çështja u regjistrua përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Nga ana tjetër, mbi dorëheqjen e z.{...}, paraqitur edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor po më datë 10.01.2019, Këshilli ka filluar procedurën e mbarimit të statusit të magjistratit për të.

Kështu, dorëheqja e z.{...} i ka kaluar për trajtim Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky i fundit, referuar kuadrit ligjor në fuqi, dispozitave kushtetuese dhe ligjore relevante për rastin në shqyrtim, rrethanave faktike, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të organeve të rivlerësimit kalimtar, si dhe opinioneve të misioneve ndërkombëtare që asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor, i propozoi Këshillit të vendoste: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit/gjyqtarit për z. {...}, më datë 28.02.2019.

Ndërkohë, përpara shqyrtimit të projektvendimit dhe relacionit përkatës të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, z. {...} paraqiti pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor një kërkesë tjetër me shkrim, protokolluar me aktin nr. 1830 prot., datë 26.03.2019. Në përmbajtje të kësaj kërkesë, z.{...} parashtronte se tërhiqej nga kërkesa për dorëheqje dhe kërkonte që ajo të mos merrej në shqyrtim nga Këshilli.

Në Mbledhjen Plenare të datës 27.03.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori në shqyrtim propozimin dhe relacionit përkatës të përgatitur nga Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në lidhje me dorëheqjen e z.{...}. Mbas diskutimeve, Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e propozimit të Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me qëllim që të trajtohej edhe kërkesa e z.{...}, bërë më datë 26.03.2019, si dhe për të thirrur dhe dëgjuar në Këshill këtë të fundit.



Në Mbledhjen Plenare të datës 24.04.2019, pasi dëgjoi z. {...} dhe shqyrtoi edhe relacionin shtesë të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i cili vijoi me të njëjtin propozim sikurse edhe më parë, duke vlerësuar se, në kushtet kur z. {...} rezultonte të kishte ushtruar të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit kundër Vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dorëheqja e tij duhet të shqyrtohej pasi të përfundonte me vendim përfundimtar procesi i rivlerësimit kalimtar për të. Mbi këtë bazë, me Vendimin nr. 57, datë 24.04.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

“Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës i gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të bëhet pas marrjes së vendimit nga Kolegji i Posaçëm të Apelit...”.

Në këtë mënyrë, Këshilli pezulloi procedurën e mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}, deri në marrjen e një vendimi, mbi ankimin e paraqitur nga ai, prej Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas nenit 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative.

Rezulton se ankimi i z. {...} është shqyrtuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në dhomë këshillimi, më datë 01.07.2020. Me Vendimin nr.10, datë 01.07.2020, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

“1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm”.

Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit i është përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.439/34 prot., datë 30.09.2020, duke u protokolluar me aktin nr. 4824, datë 02.10.2020.

Nisur sa më sipër, rezulton të ketë rënë shkak i pezullimit të procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}, prandaj Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vendosë rifillimin e kësaj procedure.

Më tej, sa i përket kësaj procedure të filluar mbi kërkesën për dorëheqje të z. {...}, në situatën aktuale, kur ai tashmë nuk është më gjyqtar, për shkak se është shkarkuar nga kjo detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit, objekti i saj tashmë është bërë i pamundur. Për këtë shkak, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të deklarojë përfundimin, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së mbarimit të statusit të

magjistratit, për z. {...}, sikurse përcakton neni 90, pika 3 në lidhje me nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative. Dorëheqja ose heqja dorë, si institut ligjor, është shprehje e parimit të autonomisë së vullnetit të një subjekti. Megjithatë, ajo lidhet me qenien e subjektit në një marrëdhënie të caktuar juridike, pasi nuk ka kuptim të heqësh dorë nga diçka që nuk e ke, ose edhe nëse e ke pasur, nuk e ke më. Për rrjedhojë, kërkesa e z. {...}, i cili ka paraqitur më herët kërkesën për heqje dorë nga statusi i gjyqtarit, lidhej pikërisht me faktin se ky subjekt në momentin që e ka paraqitur këtë kërkesë, gëzonte statusin e magjistratit/gjyqtarit. Tashmë ai nuk e gëzon më këtë status, e për rrjedhojë objekti i procedurës së deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit, inicuar fillimisht me kërkesën të tij, e pezulluar më pas nga Këshilli, tashmë është bërë i pamundur.

Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, përcakton se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”. Ndërsa neni 90, pika 3, i Kodit të Procedurave Administrative përcakton se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative”.

Sa sipër, referuar rrethanave faktike, përcaktimeve ligjore në fuqi, Komisioni i Zhvillimit të karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në tre pika.

Në pikën e 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën e fundit, pika 3 të projektvendimit përcaktohet e drejta e subjektit për t'u ankuar në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet se ai hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin.

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro,

**Brikena Ukperaj:** Pro,

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.10.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Për shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim të pjesshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 427, datë 13.10.2020, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Për shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim të pjesshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.427, datë 13.10.2020, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë edhe kjo për një ndryshim të pjesshëm të vendimit nr.427, datë 13.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe kjo çështje do relatohet nga zoti Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim për ndryshimin e pjesshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 427, datë 13.10.2020.

Mbi Kërkesën nr.345 prot., datë 13.10.2020, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 13.10.2020, ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, në tabelën që është paraqitur në këtë rast, është çështja nr. 2.

Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e Vendimit të tij “Për

rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin X/2, të Vendimit të KLGJ-së si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Në atë rast objekt shqyrtimi kanë qenë dy kërkesa të Gjykatës së Apelit të Posaçëm.

Propozimi tjetër i Komisionit ka qenë që gjyqtarët për 2 çështje gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Dhe propozimi i fundit është që për 2 çështje, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të caktohen dy të tillë, ku për secilën nga ato ai të përzgjidhet, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit edhe për çështjen nr.2, të dhënat e të cilës janë evidentuar në tabelë, për përzgjedhjen e 1 gjyqtari ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksion të përgjithshëm që kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Në bazë të shortit, për këtë çështje është caktuar gjyqtari Artur Kalaja, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Mbi këtë bazë, me Vendimin Nr.427, datë 13.10.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, pika 2, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur:

“2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale “\_\_\_”, - dhe janë të dhënat konkrete për çështjen penale.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, i caktuar për gjykimin e çështjes më lart, z.Artur Kalaja, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr.5162, datë 15.10.2020, i ka kërkuar Këshillit të rishikojë vendimin si më lart në lidhje me caktimin e tij për gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke parashtruar se referuar paragrafit X/2, të Vendimit të KLGJ-se “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” (shtuar me Vendimin nr.126, datë 06.03.2020), ai nuk plotësonte njërin nga kriteret për t’u caktuar pranë kësaj gjykate, pikërisht përvojën profesionale minimale prej 5 vjetësh si gjyqtar në çështjet penale.

Rezulton se z.Kalaja është kandidat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe në kuadër të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, ndër të tjera, është verifikuar edhe kriteri i përvojës profesionale minimale, asaj të përgjithshme, por dhe përvojës specifike në fushat e të drejtës civile dhe administrative, por se nga të dhënat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Apelit Tiranë, evidentohet dhe përvoja në fushën e të drejtës penale. Sipas të dhënave të evidentuara në Vendimin nr.332, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se z.Kalaja ka më pak se 5 vjet përvojë në fushën e të drejtës penale.

Sa sipër, rezulton që një rrethanë e tillë, pra mospasja të paktën 5 vjet përvojë në fushën e të drejtës penale nga gjyqtari Artur Kalaja të mos jetë mbajtur parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në marrjen e Vendimit Nr.427, datë 13.10.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, pika 2, përmes të cilit ky gjyqtar është caktuar për gjykimin e çështjes penale në nevojë si më lart në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është vendi për ndryshimin e pikës 2, nënndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, paragrafit I, të



Vendimit Nr. 427, datë 13.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Për gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të konsiderohen propozimet e pranura në mbledhjen e datës 13.10.2020, sa i përket gjykatave dhe kritereve që duhet të plotësojë gjyqtari që duhet të caktohet.

Në këtë rast duhet të konsiderohet përjashtimi i gjyqtarit Astrit Kalaja, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili, në shortin e datës 13.10.2020, u caktua për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen tjetër penale, në të cilën kjo gjykatë paraqiste nevojë.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Ndryshimin e pikës 2, nëndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, paragrafi I, të Vendimit Nr.427, datë 13.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në bazë të rezultateve të shortit, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të caktohet një gjyqtar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale, me të dhënat e reflektuara edhe në relacion (s’po i bëj publike).

Ndërkohë është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë këto kritere bashkëlidhur relacionit. Mbeten që të jenë 11 gjyqtarë që do duhet të shortohen, duke përjashtuar z. Arstrit Kalaja që propozojmë që të përjashtohet sikurse kemi propozuar edhe në mbledhjen e datës 13 tetor.

Nëse Këshilli nuk ka ndonjë kundërshtim në parim me këtë projektvendim, do duhet të vijojmë pastaj me procedurat e shortit.

*(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime.)*

Procedohet me shortin elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Anita Mici.

***Ilir Toska:*** Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Do duhet tani të deklarohet projektvendimi i miratuar.

***Naureda Llagami:*** Jemi dakord?

Projektvendimi është:

Ndryshimin e pikës 2, nënndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, paragrafi I, të Vendimit Nr.427, datë 13.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, znj. Anita Mici, caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} – {...}; Akuza: “Nenet 298/3, 189, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jemi dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.10.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Për shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator Erjon Muharremaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Për shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator Erjon Muharremaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës e cila ka të bëjë me komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Relatimi i kësaj çështjeje do bëhet nga zoti Muharremaj.

*Erjon Muharremaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79 shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 400, datë 07.10.2020, ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për 1 pozicion “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në zbatim të vendimit të mësipërm, ka shfaqur vullnetin për komandim një gjyqtare, për të cilën nga ana e Këshillit në mbledhje plenare, pasi është miratuar opinioni në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për komandim dhe cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, është vendosur:

Miratimi i opinionit për përfshirjen e kandidatës znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë kuadër, referuar vendimit nr. 400, datë 07.10.2020, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale filloi fazën e dytë të procedurës së komandimit, me qëllim kryerjen e vlerësimit të kandidatës, për të cilën është lejuar vijimi i procedurave për komandimin e gjyqtarës {...}, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në pozicionin e shpallur "Nëpunës përgjegjës për vlerësim".

Në fazën e dytë, procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kriterëve të komandimit. Ky vlerësim, sipas vendimit nr. 400, datë 07.10.2020, bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Vlerësimi i tyre u bë nga Komisioni në rastin konkret mbi baza dokumentare, bazuar në të dhënat e dosjes personale dhe dokumentacioni i depozituar rishtazi në Këshill, bashkëlidhur kërkesës për komandim, pa u vlerësuar i nevojshëm intervistimi.

Gjatë procedurës së vlerësimit Komisioni pati parasysh edhe kriteret preferenciale të parashikuara në vendimin nr. 400, datë 07.10.2020, sipas të cilit:

Ka përparësi kandidati që plotëson këto kriterë :

- a) Ka ekspertizë të veçantë në fushën hartimit të akteve rregullatore;
- b) Ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemin gjyqësor;
- c) Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
- d) Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- e) Ka aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Gjyqtarja {...} ushtron detyrën e gjyqtarës që prej muajit janar të vitit 2009, me një përvojë profesionale mbi 11-vjeçare, detyrë të cilën e ka ushtruar në gjykatat e shkallëve të para me juridiksion të përgjithshëm, Tiranë dhe Lushnjë. Aktualisht, ajo

ushtron detyrën e gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, duke shqyrtuar çështje të të gjitha fushave, civile, penale dhe familjare, duke qenë se në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnjë, trupa gjyqësore nuk është e ndarë në seksione. Gjatë periudhës se punës, është vlerësuar një herë, “Shumë mirë” për veprimtarinë e saj etike-profesionale për periudhën e vlerësimit 2010-2012 dhe ka përballuar një ngarkesë pune relativisht të lartë, duke iu referuar informacioneve periodike të dërguar nga kryetarët e gjykatave. Ajo ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe asaj italiane, si dhe njohuri të mira të gjuhës franceze, (të dhëna të referuara nga vetë gjyqtarja). Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj, konkludohet se ajo ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe analizohen provat në drejtim të saj. Të pesë dokumentet ligjore janë mirëstrukturuar, të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e vendimit kanë lidhje dhe janë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Nuk gjen në pjesën arsyetuese kundërthënie argumentesh, apo mospërputhje me pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.

Nisur nga mënyra e arsyetimit të dokumenteve ligjore, pavarësisht se nga ana e Komisionit nuk është bërë vlerësim i dosjeve konkrete, konstatohet gjithashtu që gjyqtarja ka aftësi të mira organizative. Ajo është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe atyre të organizuar nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nuk rezultojnë të dhëna mbi njohuri të legjislacionit të vendeve të Bashkimit Evropian, apo akte ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor, referuar pikave a dhe b të nenit 5 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se gjyqtarja është autore e librit “Paditë për mbrojtjen e të drejtave reale”, botuar në nëntor të vitit 2014.

Referuar të dhënave të mësipërme, Komisioni ka vlerësuar se kjo gjyqtare shfaq aftësi shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe ka eksperiencë personale në draftimin e akteve

rregullatore. Për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, apo edhe të veprimtarive të tjera jashtë këtij funksioni, ajo shfaq aftësi interpretuese dhe zbatuese të ligjit, si dhe aftësi teknike për kërkime ligjore mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, akte ndërkombëtare apo jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, referuar kritereve preferencialë të parashikuar në pikën 5 të vendimit nr. 104, në rastin konkret nuk mund të bëhet një renditje e gjyqtarëve, pasi numri i pozicioneve të shpallur të lirë për komandim është i njëjtë me numrin e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet e kriteret e komandimit, pra vetëm një gjyqtare.

Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon Mbledhjes Plenare:

Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i komandimit është 2 vjet. Duke marrë në konsideratë nevojshmërinë që ka struktura dhe ritmin e shqyrtimit gjyqësor sipas K.Pr.Civile, ku ndryshimi i trupit gjykues si rregull nuk përbën shkak për fillimin e gjykimit nga e para, komandimi propozohet të fillojë në datën 20.10.2020.

Komisioni propozon gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, gjyqtarja duhet të përjashtohet nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Atëherë, në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 20.10.2020.

3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**